

Njoftimi i Privatësisë i Johnson Controls



Johnson Controls, Inc. dhe kompanitë filiale të tij (së bashku të referuara si, Johnson Controls) kujdesen mbi privatësinë tuaj dhe janë të përkushtuar për të përpunuar informacionin tuaj personal në përputhje me praktikatat e drejta të informacionit dhe ligjet e aplikueshme të privatësisë së të dhënave.

Si shenjë e angazhimit tonë për privatësinë, ne kemi miratuar një set Rregullash detyruese korporative ("BCR-të"). Këto përmbajnë angazhimet tona globale për privatësinë, duke përfshirë politikën tonë rreth transferimeve të informacionit personal dhe të të drejtave të privatësisë së individëve që i shoqërojnë ato, me qëllim për të siguruar që informacioni juaj personal të jetë i mbrojtur gjatë përpunimit nga ndonjë prej filialeve tona në botë. Këto BCR duhet të miratohen nga Autoritetet Evropiane të Privatësisë së të Dhënave. BCR-ve tona mund t'u referoheni në faqen tonë të Privatësisë.

Ky Njoftim i Privatësisë i Johnson Controls mbulon temat e mëposhtme:

- [Qëllimi i këtij Njoftimi Privatësie](#)
- [Çfarë informacioni personal mund të grumbullojmë](#)
- [Mënyra se si e përdorim informacionin](#)
- [Si e mbrojmë informacionin personal o që përpunojmë për llogari të klientëve tanë](#)
- [Si e menaxhojmë privatësinë në uebsajtet/faqet tona të internetit](#)
 - Kukit, të dhënat e përdorimit dhe mjetet e ngjashme
 - Sajtet e lidhura
 - Fëmijët
- [Masat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit personal](#)
- [Ndarja e informacionit personal me palët e treta](#)
- [Transferimet ndërkombëtare të informacionit personal](#)
- [Rishikimi dhe përditësimi i informacionit personal](#)
- [Miratimi dhe zgjedhja për të lënë jashtë opsioneve](#)
- [Mbajtja e të dhënave](#)
- [Si të identifikojmë entitetin përgjegjës të Johnson Controls](#)
- [Si të na kontaktoni](#)
- [Modifikimet e Njoftimit tonë të Privatësisë](#)
- [Shtojcat lokale për vende të caktuara](#)

Qëllimi i këtij Njoftimi Privatësie

Ky Njoftim Privatësie shpjegon mënyrën se si e grumbullojmë dhe e përdorim informacionin personal të individëve në vendndodhje të ndryshme ku veprojmë. Informacioni personal është i gjithë informacioni që lidhet me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm.

Ne e grumbullojmë informacionin personal në një shumëllojshmëri mënyrash përmes aktivitetit tonë normal të biznesit, si në kontekste në linjë ashtu edhe jashtë linje. Kjo përfshin, për shembull, kur bëni porosi ose blini produkte ose shërbime, lidhni marrëveshje ose komunikoni me

ne ose vizitoni dhe përdorni uebsajtet tona. Ne marrim gjithashtu informacion personal nga klientët tanë për të kryer shërbimet për llogarinë e tyre.

Çfarë informacioni personal mund të grumbullojmë

Informacioni personal që ne grumbullojmë nga individët mund të përfshijë:

- **Informacionin e kontaktit** që na lejon të komunikojmë me ju, si p.sh. emrin tuaj, pozicionin në punë, moshën dhe prefiksin, emrin e përdoruesit, adresën postare, numrat e telefonit, adresën e emailit ose adresa të tjera që na lejojnë t'ju dërgojmë mesazhe, informacionin e kompanisë dhe informacionin e regjistrimit që jepni në uebsajtin tonë.
- **Informacionin e marrëdhënieve** që na ndihmon të kryejmë biznes me ju, si p.sh. llojet e produkteve dhe shërbimeve që mund t'ju interesojnë, preferencat e kontaktit dhe produkteve, gjuhët, vlerësimi i aftësisë paguese në kreditim, preferencat e marketingut dhe të dhënat demografike.
- **Informacionin e transaksionit** rreth mënyrës se si ju bashkëveproni me ne, duke përfshirë blerjet, pyetjet, informacionin e llogarisë së klientit, informacionin e porosive dhe kontratave, të dhënat e dërgimit, të dhënat e faturimit dhe ato financiare, detajet për historikun e taksave, transaksioneve dhe korrespondencës, si dhe informacione në lidhje me mënyrën se si ju përdorni dhe bashkëveproni me uebsajtet tona.
- **Informacionin e sigurisë dhe pajtueshmërisë** që na ndihmon të sigurojmë interesat tona, duke përfshirë informacionin për kontrollat e konflikteve, parandalimin e mashtrimeve dhe verifikimin e brendshëm, si edhe informacionin e nevojshëm për sigurinë e ambienteve tona, të tilla si regjistrimet vizuale.

Mënyra se si e përdorim informacionin

Ne e përdorim informacionin personal në kontekstin e aktiviteteve tona normale të punës, që përfshin qëllimet e mëposhtme:

- Përbushjen e porosive tuaja për produkte ose shërbime dhe aktivitete të ngjashme, si p.sh. dhënieve të produkteve dhe shërbimeve, shërbimin e klientit, menaxhimin e llogarisë dhe faturimit, mbështetjen dhe trajnimin, si dhe për të ofruar shërbime të tjera që lidhen me blerjen tuaj.
- Menaxhimin e detyrimeve tuaja kontraktuale dhe vazhdimin e marrëdhënieve tuaja me ne, duke përfshirë bashkëveprimin me ju, informimin tuaj rreth produkteve ose shërbimeve tona, si edhe ofertat speciale dhe promocionet.
- Garantimin e sigurisë së uebsajteve tona, rrjeteve, sistemeve, ambienteve tona, si edhe mbrojtjen tonë kundër mashtrimeve.
- Menaxhimin e nevojave tona të përditshme të biznesit, si p.sh. përpunimin e pagesave dhe menaxhimin e llogarisë financiare, zhvillimin e produkteve, menaxhimin e kontratave, administrimin e uebsajtit, përbushjen, drejtimin e korporatës, auditimin, raportimin dhe pajtueshmërinë ligjore.

Si e mbrojmë informacionin personal që përpunojmë për llogari të klientëve tanë

Në disa raste, ne e përpunojmë informacionin personal për llogari të klientëve tanë si shërbim (në cilësinë e përpunuesit të të dhënave). Ne e grumbullojmë dhe e përpunojmë këtë informacion vetëm siç udhëzohemi nga klienti ynë dhe nuk do ta përdorim apo zbulojmë atë për qëllimet tona.

Ne kemi kontrolle të sigurisë së informacionit për të mbrojtur informacionin tuaj dhe do ta zbulojmë ose transferojmë informacionin personal vetëm sipas udhëzimit nga klienti ose për të dhënë shërbimin e kërkuar. Përveçse kur udhëzohet ndryshe nga klienti, ne do ta trajtojmë informacionin personal që përpunojmë për llogari të klientëve tanë në përputhje me angazhimet tona rreth zbulimit dhe transferimit siç përcaktohet në këtë njoftim.

Si e menaxhojmë privatësinë në uebsajtet/faqet tona të internetit

Kukit, të dhënat e përdorimit dhe mjete të ngjashme

Kur vizitoni uebsajtet/faqet tona të internetit, ne grumbullojmë informacione të caktuara me mjete të automatizuara, duke përdorur teknologji të tilla si kukit, etiketat piksel, mjetet e analizimit të shfletuesit, regjistrimet e serverit dhe sinjalizuesit e uebit. Në shumë raste, informacioni që grumbullojmë duke përdorur kukit dhe mjetet e tjera përdoret në mënyrë të pidentifikueshme pa iu referuar informacionit personal.

Kukit janë skedarë të vegjël që një uebsajt i transferon në diskun e ngurtë të kompjuterit tuaj ose një pajisjeje tjetër përmes shfletuesit të uebit kur vizitoni një uebsajt. Ne mund të përdorim “kukit” për të bërë më efikas hyrjen në uebsajte dhe përdorimin, si dhe për të përshtatur preferencat tuaja të shfletimit dhe për të përmirësuar funksionimin e uebsajteve tona. Kukit mund të përdoren për menaxhimin e performancës, grumbullimin e informacionit rreth mënyrës se si përdoret uebsajti ynë për qëllime analitike. Ato mund të përdoren gjithashtu për menaxhimin e funksionimit, duke na dhënë mundësinë ta bëjmë vizitën e përdoruesit më efikase, për shembull, duke kujtuar preferencat gjuhësore, fjalëkalimet dhe të dhënat e hyrjes.

Ka dy lloje kukish: kuki sesionesh, të cilat fshihen nga pajisja pasi largoheni nga uebsajti; dhe kuki të përhershme, të cilat qëndrojnë në pajisjen tuaj për një kohë më të gjatë ose derisa t'i fshini manualisht.

Ne mund të përdorim kuki Flash (të njohura edhe si Objekte të Ruajtura Lokale) dhe teknologji të ngjashme për të personalizuar dhe përmirësuar përvojën tuaj në internet. Adobe Flash Player është një aplikacion që lejon zhvillimin e shpejtë të përmbajtjes dinamike, si p.sh. videoklipet dhe animacionet. Ne i përdorim kukit Flash për qëllime sigurie dhe për të ndihmuar që të kujtojmë cilësimet dhe preferencat në mënyrë të ngjashme me kukit e shfletuesit, por këto menaxhohen përmes një ndërfaqeje të ndryshme nga ajo që ofrohet nga shfletuesi juaj i uebit. Për të menaxhuar kukit Flash, ju lutemi vizitoni uebsajtin e Adobe <http://kb2.adobe.com/cps/526/52697ee8.html> ose vizitoni www.adobe.com. Ne mund të përdorim kuki Flash ose teknologji të ngjashme për qëllime të synuara sjelljeje ose për të servirur reklama të bazuara në internet.

Edhe regjistrat tanë të serverëve grumbullojnë informacion rreth mënyrës se si përdoruesit i përdorin uebsajtet (të dhënat e përdorimit). Këto të dhëna mund të përfshijnë emrin e domenit të një përdoruesi, gjuhën, llojin e shfletuesit dhe sistemin operativ, ofruesin e shërbimit të internetit, adresën e protokollit të internetit (IP), sajtin ose referencën që e drejton përdoruesin te uebsajti, uebsajtin që po vizitonit përpara se të vinit në uebsajtin tonë dhe uebsajtin që vizitoni pasi largoheni nga sajti ynë, si dhe sasinë e kohës së kaluar në uebsajt. Ne mund të monitorojmë dhe përdorim të dhënat e përdorimit për të matur performancën dhe aktivitetin e uebsajtit, për të përmirësuar dizajnin dhe funksionimin e uebsajtit apo për qëllime sigurie.

Ne mund të përdorim gjithashtu etiketa piksel dhe sinjalizues uebi në uebsajtin tonë. Këto janë imazhe të vogla grafike të vendosura në faqet e uebit ose në emailt tona që na lejojnë të përcaktojmë nëse keni kryer një veprim specifik. Kur hyni në këto faqe ose hapni apo klikoni mbi një email, etiketat piksel dhe sinjalizuesit e uebit krijojnë një njoftim për këtë veprim. Këto instrumente na lejojnë të masim reagimin ndaj komunikimeve tona dhe të përmirësojmë faqet e uebit dhe promocionet tona.

Cilësimet e shfletuesit mund t'i ndryshoni për të bllokuar ose për t'ju njoftuar kur merrni një kuki, për të fshirë kukit ose për të shfletuar uebsajtin tuaj duke përdorur cilësimin e përdorimit anonim të shfletuesit. Ju lutemi referojuni udhëzimeve të shfletuesit tuaj ose ekranit të ndihmës rreth mënyrës së rregullimit ose modifikimit të cilësimeve të shfletuesit. Nëse nuk bini dakord të përdorni kukit tona ose teknologji të ngjashme që ruajnë informacionin në pajisjen tuaj, duhet të ndryshoni përkatësisht cilësimet e shfletuesit tuaj. Ju duhet të kuptoni se disa veçori të uebsajteve tona mund të mos funksionojnë mirë nëse nuk pranoni kukit ose këto teknologji.

Aty ku kërkohet nga ligji në fuqi, do t'ju kërkohet të jepni pëlqimin për kuki të caktuara dhe teknologji të ngjashme përpara se ne t'i përdorim ose t'i instalojmë ato në kompjuterin tuaj ose në pajisje të tjera.

Ndarja e të Dhënave dhe Kërkesat e Shfletuesit për Mos-monitorim

Duke qenë se ne nuk monitorojmë (dhe nuk lejojmë të tjerët të monitorojnë) vizitorët e uebsajtit tonë, ne nuk i përpunojmë sinjalet e shfletuesve të uebit për mos-monitorim. Për të mësuar më shumë rreth sinjaleve të monitorimit dhe Mos-Monitorimin, ju lutemi vizitoni <http://www.allaboutdnt.org/>

Sajtet e lidhura

Ne mund të ofrojmë lidhje te uebsajtet e palëve të treta (“sajtet e lidhura”) nga uebsajtet tona. Sajtet e lidhura nuk shqyrtohen, kontrollohen apo ekzaminohen nga ne domosdoshmërisht. Çdo sajt i lidhur mund të ketë kushtet e veta të përdorimit dhe njoftimin e vet të privatësisë, dhe përdoruesit duhet të njihen dhe duhet të pajtohen me këto kushte kur përdorin sajtet e lidhura. Ne nuk jemi përgjegjës për politikën dhe praktikën e ndonjë sajti të lidhur, ose lidhjet shpesh që përmbajnë ato. Këto lidhje nuk nënkuptojnë aprovimin tonë të sajteve të lidhura ose të ndonjë kompanie apo shërbimi

dhe ne i inkurajojmë përdoruesit që të lexojnë kushtet dhe njoftimet e këtyre faqeve përpara se t'i përdorin ato.

Fëmijët

Uebsajtet tona nuk u drejtohen fëmijëve dhe ne nuk i përdorim uebsajtet tona për të kërkuar me dijeni informacion personal nga fëmijët ose për t'u tregtuar fëmijëve. Nëse ne mësojmë se një fëmijë ka dhënë informacion personal përmes një prej uebsajteve tona, ne do ta heqim atë informacion nga sistemet tona.

Masat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit personal

Ne zbatojmë masat e përshtatshme teknike, fizike dhe organizative që janë projektuar në mënyrë të arsyeshme për të mbrojtur informacionin personal kundër shkatërrimit, humbjes, ndryshimit, zbulimit ose aksesit të paautorizuar, në mënyrë aksidentale ose të paligjshme, në veçanti aty ku informacioni personal transferohet përmes një rrjeti, dhe kundër të gjitha formave të tjera të paligjshme të përpunimit. Aksesit në informacionin personal kufizohet me marrësit e autorizuar në bazë të asaj që u nevojitet të dinë. Ne kemi një program gjithëpërfshirës të sigurisë së informacionit i cili është në raport të drejtpërdrejtë me rreziqet që shoqërojnë përpunimin. Programi përshtatet në mënyrë të vazhduar për të zbutur rreziqet operacionale, si dhe për të siguruar mbrojtjen e informacionit duke marrë në konsideratë praktikatat e pranuar në rang industri. Ne do të përdorim gjithashtu masa të shtuara sigurie kur përpunojmë informacione personale me natyrë të ndjeshme.

Ndarja e informacionit personal me palët e treta

Ne mund të përdorim palët e treta për të ofruar ose kryer shërbime dhe funksione për llogarinë tonë. Ne mund të vëmë në dispozicion të këtyre palëve të treta informacion personal, sipas nevojës, për të kryer këto shërbime dhe funksione. Çdo akses në atë informacion personal do të jetë i kufizuar me qëllimin për të cilin është dhënë informacioni.

Ne mund të vëmë informacion personal në lidhje me individët në dispozicion të autoriteteve publike ose gjyqësore, personelit dhe agjencive të zbatimit të ligjit siç kërkohet nga ligji, duke përfshirë agjencitë dhe gjykatat në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera ku ne veprojmë. Ku lejohet nga ligji, ne mund të zbulojmë informacion të tillë te palë të treta (duke përfshirë këshilluesit ligjorë) kur është e nevojshme për krijimin, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore ose për të zbatuar ndryshe të drejtat tona, për të mbrojtur pronën ose të drejtat tona, pronën ose sigurinë e të tjerëve, ose sipas nevojës për të mbështetur funksionet e auditimit të jashtëm, të pajtueshmërisë dhe të drejtimit të korporatës.

Informacioni personal mund të transferohet te një palë e tretë që blen të gjitha ose një pjesë të kapitalit ose asetëve të Johnson Controls ose operacioneve të tij të biznesit në rast shitjeje, shkrirjeje, likuidimi, shpërbërjeje, ose shitjeje apo transferimi të asetëve të konsiderueshme të Johnson Controls ose të ndonjë prej operacioneve të tij të biznesit. Ne gjithashtu mund të transferojmë dhe ndajmë informacione të tilla me filialet tona brenda grupit, në përputhje me ligjin në fuqi.

Transferimet ndërkombëtare të informacionit personal

Palët e treta, degët dhe filialet tona të cilat mund të zbulohet informacioni juaj personal mund të ndodhen në mbarë botën; prandaj informacioni mund të dërgohet te vendet që kanë standarde të mbrojtjes së privatësisë të ndryshme nga vendi ku ju banoni. Në raste të tilla, ne marrim masat e nevojshme për të siguruar që informacioni juaj personal të marrë një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje.

Për të siguruar që informacioni personal nga individët në Zonën Ekonomike Evropiane (“ZEE”) dhe Zvicër të marrë një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje kur transferohet te Johnson Controls në SHBA, Johnson Controls Inc. (dhe filialet e SHBA-së të zotëruara plotësisht nga ne) ka certifikuar përputhshmërinë e tij me **Kuadrin e Sigurisë** të përcaktuar nga Departamenti Amerikan i Tregtisë për transferimet e informacioneve personale nga ZEE-ja dhe Zvicra në SHBA.

Për më shumë informacion ju lutemi lexoni Deklaratën e Privatësisë së Kuadrit të Sigurisë të Johnson Controls, Inc. të disponueshme në faqen e Privatësisë.

Ne kemi miratuar gjithashtu një set Rregullash Detyruese Korporative (BCR-të), të cilat janë miratuar nga Autoritetet përkatëse të Mbrojtjes së të Dhënave, në fuqi nga data 6 janar 2015. BCR-të sigurojnë që informacioni personal i individëve të mbuluar në ZEE dhe Zvicër të jetë i mbrojtur gjatë përpunimit nga një prej filialeve tona në botë.

Zbuloni më shumë rreth **Rregullave Detyruese Korporative** të disponueshme nga faqja e Privatësisë.

Rishikimi dhe përditësimi i informacionit personal

Ju mund të kërkonti të keni akses, të korrigjoni ose të përditësoni informacionin tuaj personal duke kontaktuar me Zyrën tonë të Privatësisë përmes lidhjes së mëposhtme: [Formulari i kontaktit të JCI](#).

Miratimi dhe zgjedhja për të lënë jashtë opsioneve

Duke na dhënë neve informacion personal, ju kuptoni dhe bini dakord me grumbullimin, përpunimin, transferimin ndërkombëtar dhe përdorimin e këtij informacioni siç përcaktohet në këtë Njoftim Privatësie. Aty ku kërkohet nga ligji në fuqi, ne do të kërkojmë miratimin tuaj të qartë.

Ne mund të kundërshtojmë gjithmonë përdorimin e informacionit tuaj personal për qëllime direkte marketingu ose mund të tërheqim çdo miratim të dhënë më parë për një qëllim specifik, falas, duke klikuar lidhjet përkatëse të uebsajtit, duke ndjekur udhëzimet që përmban një email ose duke kontaktuar me Zyrën tonë të Privatësisë përmes lidhjes së mëposhtme: [Formulari i kontaktit të JCI](#).

Mbajtja e të dhënave

Ne do t'i mbajmë të dhënat tuaja personale për sa kohë që është e nevojshme të arrihet qëllimi për të cilin janë grumbulluar, zakonisht për kohëzgjatjen e një marrëdhënieje kontraktore dhe për çdo periudhë pas saj siç kërkohet ligjërisht ose lejohet nga ligji në fuqi.

Si të identifikojmë entitetin përgjegjës të Johnson Controls

Për të identifikuar entitetin e Johnson Controls përgjegjës për përpunimin e informacionit tuaj personal, ju mund të pyesni kontaktin tuaj të biznesit të Johnson Controls, të konsultoheni me listën e vendndodhjeve tona në uebsajtet publike të Johnson Controls ose mund të kontaktoni me Zyrën tonë të Privatësisë.

Si të na kontaktoni

Nëse dëshironi të komunikoni me ne në lidhje me çështjet e privatësisë ose keni pyetje, komente ose ankesa, ju lutemi kontaktoni me Zyrën tonë të Privatësisë, duke klikuar lidhjen e mëposhtme: [Formulari i kontaktit të JCI](#).

Modifikimet e Njoftimit tonë të Privatësisë

Ne ruajmë të drejtën ta ndryshojmë, modifikojmë dhe përditësojmë këtë Njoftim Privatësie në çdo kohë. Ju lutemi kontrolloni në mënyrë periodike për t'u siguruar që keni shqyrtuar njoftimin më të fundit. Nëse ndryshimet do të ndikojnë në mënyrë materiale mënyrën se si përdorim apo zbulojmë informacione personale të grumbulluara më parë, ne do t'ju njoftojmë rreth ndryshimit duke dërguar një njoftim në adresën parësore të emailit që shoqëron llogarinë tuaj.

Shtojcat lokale për vende të caktuara

Ne e kemi zgjeruar Njoftimin e Privatësisë me informacion specifik për vende të caktuara ku kërkohet nga ligji vendas në fuqi. Këto njoftime shtesë mund t'i gjeni përmes lidhjeve të shtojcave lokale në faqen e Privatësisë.

Kjo deklaratë Privatësie është në fuqi nga data 28 janar 2015